

Dokumentët që botohen janë pjesë e dosjes hetimore e gjyqësore të intelektualit Lazër Shantoja, meshtar. Bjen menjëherë në sy fryma dhe toni i hartimit të tyre dhe se qëllimi ka qenë dënimi me vdekje paraprakisht i të pandehunit. Emni i avokatit mbrojtës nuk del në asnjë dokument; të pandehunit nuk i asht dhanë e drejta e mbrojtjes ligjore. Po ashtu mungojnë deponimet e tija mbi akuzat që i drejtoheshin. Këto përcillen në dokumente vetëm tërthorazi, të interpretueme nga prokurori dhe me ngjyrimë emocionale.

Duhet saktësue, pra, se Lazër Shantoja nuk asht pushkatue pa gjyq sikur asht pohue vazhdimisht deri sot, por mbas një gjyqi të parregullt në gjykatë të faktit dhe në atë të naltë.

Veprat për të cilat akuzohet janë krye të gjitha para miratimit të ligjit nr. 21, 15 dhjetor 1944 dhe ligjit 41 të 14 janarit 1945 në bazë të të cilave ka marrë dënimin. E prap, këtu mund të shtojmë se prej këtyne dy ligjeve vetëm i pari ka të bajnë me “sabotatorët e luftës, të pushtetit dhe armiqve të popullit”; i dyti ka të bajnë me “organizimin dhe funksionimin e gjykatave ushtarake”, pra asht një ligj që flet për vlefshmëninë e gjykimit dhe jo për vepra penale. Nënshkrimi i dom Lazrit – që karakterizohet nga një kaligrafi e dobët, tue pasë parasysh shkrimin e tij të zakonshëm – flet tërthorazi për torturat të cilave i ishte nënshtrur e për të cilat ka dëshmi të tjera të drejtëpërdrejta.

Ngrihet pyetja se ç’nevojë kanë pasë me e torturue gjatë hetuesisë kur për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohet, Shantoja ka folë haptas dhe ka botue edhe artikuj të shumtë.

Vendimi i gjykatës parashikonte edhe sekuestrimin e të gjithë pronës së tij. Këtu ban pjesë edhe korrespondenca shumë e gjanë e Shantojës, e cila ka humbë pa lanë gjurmë. Po ashtu në dokumentet gjyqësore thuhet se asht shqyrtue ditari i Shantojës por ky nuk ban pjesë në dosjen e tij hetimore të tashme dhe deri më sot nuk dihet ku ka përfundue.

Një tjetër pikë e errët, që ngjall shumë pyetje, asht se komunikata e Prokurorisë së Gjykatës së Naltë Ushtarake drejtue Gjykatës së Naltë Ushtarake, Tiranë, e ku kërkohet miratimi i vendimit të Gjykatës Ushtarake, Shkodër asht hartue po në atë ditë kur asht krye edhe gjykimi dhe vendimi i Gjykatës së Naltë Ushtarake.

\* \* \*

Nuk mund të merremi me të gjitha akuzat kundër Shantojës por do të ndalemi gjithësesi te dy-tri prej tyre: e para, se ka qenë antizogist dhe

se ka përgatitë rrëzimin e Zogut si bashkëpunëtor i Mustafa Krujës dhe vendosjen e një rregjimi fashist me një princ të Shtëpisë Savoja. Akuzuesi nuk ka vë re, se antizogizmi i tij duhet të ishte quejt meritë e jo akuzë; përveç kësaj, miqësia para 1939 me Mustafa Krujën nuk përban asnjë krim për sa kohë Kruja nuk ishte emnue ende kryeministër i Shqipnisë. Prandaj, kjo akuzë tingëllon e formuluar nga një gjykatë zogiste ma shumë se nga një gjykatë partizane.

Tjetër, akuza se ka marrë subvencione nga italianët si i emigruem politik, nuk qëndron ose të paktën nuk sillet asnjë fakt i prekshëm për të. E para, Shantoja si emigrant politik (1925-1939) nuk ka jetue në Itali por në Jugosllavi, Austri dhe Zvicër, kryesisht. Përveç kësaj, italianët nuk kishin asnjë interes të mbanin gjallë antizogistët në një kohë kur Konti Ciano i kishte punët vaj me Zogun dhe ishin nënshkrue disa marrëveshje që e robnonin Shqipninë. Por nga ana tjetër asht i vërtetë fakti se emigrantët politikë në Itali, edhe në vendet e tjera, kanë marrë një lloj mbështetjeje financiare sa me mbajtë frymën gjallë.

Gjithsesi mbetet akuza për vendosjen e një princi të Shtëpisë Savoja dhe e dyta, fjalimi i 28 nandorit 1939 të cilat nuk mund të kapërcehen pa u ndalë me i shtjellue pak.

Në një gjendje të zakonshme, në kushte të pranueshme të jetës politike, përpjekjet për rrëzimin e qeverisë së vendit me dhunë quhen krim dhe përbajnë tradhti të naltë kundër atdheut. Por mënyra me të cilën kishte marrë pushtetin, ishte shpallë mbret dhe mbante sundimin Ahmet Zogu, dëshmonin kundër tij. Njëherë që ky të rrëzohej, mbetej si rrugëdalje vetëm zëvendësimi i tij, por jo ndërrimi i formës së regjimit. Ndërrimi i formës së regjimit nga monarki në republikë (res publica), në një kohë kur shumica dërrmuese e popullsisë ishte fshatare dhe kur Shqipnija ishte e rrethuar nga tri mbretëni, sigurisht që do ta kishte izolue vendin tonë. Aventura me një qeveri demokratike kishte dështue një herë në 1924 prandaj nuk mund të pranohej si rrugëdalje pikërisht prej atyne që e kishin vëjt njëherë këtë dështim.

Shestimet për pushtimin e Shqipnisë ishin ba me kohë prej italianëve. I dërguemi i Mussolinit, Giovanni Giro dhe konsull Meloni në Shkodër, iu premtuen antizogistëve se do të vendosnin një princ të Shtëpisë Savoja në krye të mbretnisë Shqiptare. Për veprimtarinë e këtyne dy personave ka dëshmi të mjaftueshme (Letërkëmbimi Kruja-Margjokaj; Kujtime të një jete së kaluar, të dom Ndoc Nikës, etj). Qenë pikërisht këta të dy që nxitën disa shqiptarë në Shqipni t'i dërgonin letra Mussolinit ku i kërkonin rrëzimin e Zogut. Që këto letra kanë qenë të diktuar nga një dorë e vetme shihet qartë pse të gjithë dërguesit kërkojnë me ngulm, njëgoje, ardhjen e Kontit Ciano porsa të kryej pushtimi. (Shih: *I significativi appelli del popolo albanese*, "Corriere della Sera", 9 aprile 1939, fq. 2.)

Këto letra janë dërgue nga Gjon Marka Gjoni (10 Janar 1939); Maliq Bushati; Nush Bushati (3 shkurt 1939); Cen Elezi, Xhafer Taga, Kolë Ndou, Lulash Gjeloshi; Jakë Koci dhe Miftar Koloshi (15 shkurt 1939); Ndoc Pistulli (15 dhjetor 1938); avokat Çelkupa (11 Shkurt 1939). Por duhet nënvizue se në asnjë prej këtyne letrave – botue së bashku te “Corriere della Sera” – nuk përmendet e as bahet fjalë për një princ të Shtëpisë Savoja. Kjo pse italianët, mbas pushtimit, kërkuen që kunorën t’ia jepnin Viktor Emanuelit II. Nuk vepruen kështu me kroatët. Mbas pushtimit të Jugosllavisë (prill 1941) Kroacia shpalli shkëputjen e saj prej Mbretnisë Jugosllave por ruejti formën e regjimit mbretnor. Kësaj herë italianët vunë Aimonin, Dukën e Aostës si princ të vendit. Këtë kroatët e paguen tue i lëshue Italisë pothuëjse gjithë Dalmacinë dhe kjo lëvizje politike i kushtoi shumë randë Ante Paveliqit, udhëheqësit të ustashevë.

Por ndërsa Kroacia e pamvarun coptohej tokash – flasim për vjetin 1941– Shqipnia, që tashma e kishte bjerrë pavarësinë, zgjanohej përgjatë gjithë perimetrit të vet. Bashkoheshin kështu me tokën amë viset që ishin marrë nga fqinjët qysh nga koha e Traktatit të Shën Stefanit e në vijim. Këto paradokse që filloi me shpalosë pushtimi italian e ndanë opinionin publik shqiptar në dy krahë, “pro” dhe “kundër”. Këto paradokse u shtynë edhe ma thellë. Fjala vjen, Instituti i Studimeve Shqiptare –ku ishte anëtar edhe Shantoja– u kthye në një qendër të përhapjes së idesë kombëtare shqiptare dhe me veprimtarinë e tij shkencore hodhi themelet e universitetit të ardhshëm të Tiranës. Fakti që merrte pjesë vetë kryeministri Kruja tregon për vijën politike të qeverisë së tij në kundërshtim me politikat fashiste.

Antizogistët ishin nxanë ngushtë nga italianët që s’e mbajtën premtimin për një princ të Shtëpisë Savoja por edhe italianët tue mos iu dhanë shqiptarëve një princ të Savojës sikur kishte qenë plani, e nxunë veten në çark pse ofiqet e kambët e nalta nuk mund t’ua ofronin kurrkujt tjetër përposë se kundërshtarëve të Zogut. Grupimeve të tjera politike në vend, italianët nuk mund t’i besoshin ngaqë këto e quanin ndërhyrjen italiane pushtim në vështrimin e plotë të fjalës.

Fjalimi i flamurit që mban Shantoja në Tiranë, me 28 nandor 1939, rradhit dhe përmbledh një mbas një shumë kundërshti.

E para, një intelektual si Shantoja që kishte vuejt për pavarësinë e vendit të tij (ai edhe e gjithë familja e tij), tashti pohon se nuk ka pavarësi absolute për një vend të vogël si Shqipnia dhe se të gjetun mes dy racash, sllavëve të jugut dhe latinëve, nga ana tjetër, do të tërhiqej *fatalisht* prej njeves ose tjetrës. E këtu përdorë jo padashje një ndajfolje domethanëse. (Shantoja ishte burgosë një herë nga italianët në 1919 dhe ishte mbajte nën mbikqyrje).

E dyta, mendon se me pushtimin italian mbaron sundimi anadollak e orientalist i politikës. Këto janë dy arsye kryesore që ky fjalim i shpalos

mirë, natyrisht, nëse përjashtojmë retorikën.

Ç'e shtynte me dalë me këto pohime në skenën e re politike të Shqipnisë? Këtu do të ishte me vend, ndoshta, të pyesnim veten si do t'i jetë dukë shoqniya shqiptare Shantojës tashti (1939) që ishte kthye nga Zvicra, mbas 14 vjetësh mërgim. Nuk kemi dëshmi për këtë, por poeti Filip Shiroka pat mbetë aq i zhgënjyem nga vizita në atdhe (1933), sa u largue me përshtypje aspak të mira.

Mbreti porsa kishte ikë dhe deri në çastet e fundit kishte ndjekë politikën e tij të vrasjeve mbas shpine – aq sa asnjë bashkëpunëtor i tij nuk ndjehej i sigurtë – dhe të rryshfeteve dhe shpërblimeve për shërbëtorët. Ata që e njihnin nuk mund të zhgënjeheshin prej tij. Orienti si aspiratë, që ma fort se konceptim i jetës politike dhe shoqnore dukej si dënim, endej kërcnueshëm dhe vazhdimisht mbi politikën shqiptare dhe popullin. Do të shfaqej prap mbas kapitullimit të Italisë fashiste, atëherë kur edhe gjermanët po tërhiqeshin nga Ballkani. Dëshmojnë për këtë, sa për shembull, një varg artikujsh të gjatë, emfatikë mbi Turqinë të Egerem Telhajt te gazeta “Bashkimi i Kombit” (1943-1944).

Nga ana tjetër që Shantoja e antizogistët e nuk e kanë dashtë asimilimin kulturor dhe idelogjik të popullit shqiptar nga Italia e dëshmon mjaftueshëm vetë veprimtaria shkencore e Institutit të Studimeve Shqiptare.

Gjykimi që mund të japë njeriu i sotëm për Shantojën asht shumë i ndërlikuem pse veprat penale për të cilat akuzohet nuk janë krye ndërsa ngjarjet historike në të cilat ai asht përfshi, ose ka qenë protagonist, po, kanë ndodhë. Pra, mund t'a gjykojmë vetëm nëse gjykojmë atë pjesë historie që lidhet me të. Mund ta gjykojmë negativisht, nga pikëpamja historike, për mbështetjen e dhanë pushtimit italian si një regjim që shkatërroi bazën e sistemit të drejtësisë shqiptare, gja që u pa qartas në 1943 dhe në 1944 e që ende sot e kësaj dite vuen për pavarësi; mund ta dënojmë pse pushtimi italian, në mënyrë të drejtëpërdrejtë, qe shkaktari i fillimit të përplasjeve brenda grupeve të ndryshme politike shqiptare.

Historia si shkencë përcjellë në mënyrë të pashmangëshme edhe kërkesën për një qëndrim moral e qytetar të secilit individ që informon. Prandaj shtron përpara nesh pyetjen shtrënguese, të randë e të bezdisshme: “Po ti, çfarë qëndrimi do të kishe mbajtë në ato rrethana historike?”. Kësaj pyetje i asht përgjegjë edhe vetë trupi gjykues. E ngaqë mospërputhja e përgjegjes së trupit gjykues me atë të Shantojës ishte e dukshme, asht mendue se ky antagonizëm mjaftonte për dënimin e tij.

Kësaj pyetjeje do të vazhdojmë t'i përgjegjemi edhe ne sot. Secili në mënyrën e vet, tue e caktue kufinin e objektivitetit historik në varësi të moralit individual. Dhe në një kohë kur e gjithë shoqniya jonë vuen nga mungesa kronike e një moralit kolektiv, një moralit që nuk pranon, fjala vjen, që shtetasit e një vendi të mos iu binden ligjeve që kanë miratue me

vullnet të lirë, kuptohet që përgjegja do të jetë kryesisht moralizuese.

Kështu, sa herë zhvillohen debate televizive mbi historinë – zakonisht krejt të padobishme për pasunimin e historisë por me shumë ndikim të dëgjuesit – mbërrihet temperatura e vlimit. Ky është çasti kritik kur historia mund të manipulohet tue e vënë në funksion të idesë moralizuese të secilit prej nesh.

Pikërisht këtu duhet të kemi mirë parasysh se moralizimi zhvillohet e ndryshon me kohë, ndërsa ngjarjet historike mbeten të pacënueshme dhe të pandryshueshme në çastin kur dalin prej vektorit kohë.

\* \* \*

Dom Lazër Shantoja është një prej 38 martirëve shqiptarë që Selia e Shenjtë njohu si të tillë kohët e fundit. Kur flasim për këtë aspekt të jetës së Shantojës duhet të kemi parasysh se cilësimi “martir” nuk buron nga veprimtaria politike e as nga ajo intelektuale e një individit. Titulli “martir” lidhet thjeshtë me çastet e fundit të jetës, mundimet, torturat që heq dhe qëndrimin fisnik të të krishtenit përpara vdekjes.

## **DOKUMENTE ARKIVORE**

USHTRIA NACIONAL ÇLIRIMTARE SHQIPTARE

SHTABI I PERGJITHESHEM

GJYKATA E NALTË USHTARAKE

Nr. i vendimit 5.

### AKT-GJYKIM

#### **N'EMEN TE POPULLIT SHQIPTARË**

Gjykata e Naltë Ushtarake e formueme prej:

|                     |         |
|---------------------|---------|
| Gaqo Floqi          | Kryetar |
| Frederik Nosi Major | Antar   |
| Veledin Zejneli     | Antar   |

Ne prezencen e Prokurorit Myftar Tares dhe me asistencen e Sekretarit Jani Thoma, sot me date 2-Fruer-1945 mori ne shqyrtim aktet e te pandehunit DON LAZER SHANTOJA i biri i KELIT dhe i LUÇISË vjeç 52 lindun në Shkodër banues po atje, Priift Katolik, i denuar me akt-gjykimin e Gjykes Ushtarake te Krahines Ushtarake te Korpusit III Shkoder Nr. I d. 30-I- me Vdekje per shkak se ka qenë armik i Popullit, ne baze te nenit I te Ligjes Nr. 21 D. 15-12-1944 si sabotator i luftes dhe i Pushtetit te Popullit

### Gjykata:

Mbasi shqyrtoje proceset e para te mbajtura mbi pyetjen e te akuzuarit prej organeve kompetente:

Mbasi shqyrtoje proceverbalin e rrjedhjes se gjykimit para gjyqit te faktit;

Mbasi shqyrtoje te gjitha aktet e dokumentat qe bejne pjese ne kete dosje (ditari doreshkrim i te pandehurit);

Mbasi mori mejetimin e Prokurorit prane kesaje Gjykate, i cili kerkon te vendoset aprovimi i ketij akt-gjykimi si i rregullshem dhe i ligjshem;

mbasi bisedoje ceshtjen nga pikepamja e faktit dhe e se drejtes;

### Observon:

NE FAKT: DON LAZER SHANTOJA para dates 7-Prill-1939 ka qene ne bashkepunim dhe 1)mareveshtje te plote me tradhtarin Mustafa Krujen per lidhjen e akordit per permbyshjen e regimi Zogut midis grupit te Mustafa Krujes dhe 2)te grupit Bashkimi Kombetar lidhur ne viti 1938, si dhe per vendosjen e nji regjimi fashist ne Shqiperi de nalthe sjelljen ne fron te nji Princi prej shtepise Savoja si Mbret i Shqiperise; 3) ka marre subvencione nga Fashizmi italian si i merguar politik. Vepra e te nalt permendunit cilesohet si nje trathiti e nalte kundra interesave t'Atdheut, Indipendences dhe te integritetit tokesuer te Shqiperise parashikuar prej nenit 15 te Ligjes Nr. 41 D. 14-1-1945.

Mbas agresionit fashist te 7-Prillit-1939 asht kthye ne Shqiperië dhe ka bashkepunuar politikisht me anmikun ne sferat e nalta te politikës te regjimit fashist dyke u bere agjenti ma i besueshem i Luogotenences dhe i d'Angelis e Meloni-t.

Në vjetin 1940 asht ngarkar prej Luogotenences me mision per te vajtur n'Egipt ku ka mbajte konferenca ne kolonine shqiptare t'atjeshme tue ber propagande per fashizmin dhe ka pregatit terrenin per veprimet e ardheshme ushtarake qe do te ndodhnin atje me rastin e hyrjes t'Italise Fashiste ne lufte kondra Aleateve te mbedhaj Anglo-France-Amerikë.

Ka propaganduar me demagogji te pa shoqe si ne token shqiptare ashtu edhe n'Itali me ane te radio-s (agitator) dhe me ane te shtypit (publicist) duke mbajtur edhe konferenca e fjalime si P. Sh. Fjalimi i mbajtur me rastin e dorezimit te Flamurit Shqiptar ne Rome me date 28-shtator-1939 (sic). Ky fjalim asht shtypur edhe ne nje broshure te vecante me titullin "Shqiperija ne Kuadrin e Perandorise Romake" ku midis te tjerash i pandehuni ne faqen 4 ka theksue: "Sot e mbrapa Shqipnija do te bahet dhe do te mbetet per jete Shqipni Romake, Shqipni Fashiste. E po kete dite dy flamuj te lumnueshem nisen te valojne ne nji shtize te vetme; dy popuj fisnik e te vjeter i lidhi

nji fat i vetem dhe i pandarë". Tradhetija e tij vihet ne dukje fare mire ne faqen 5 te broshures ku midis te tjerave ka theksue "Populli shqiptar nuk ka mujt kurr me i tregue botes virtytet e tij te races se vjeter; veçse ne gji te nji perandorije, ne Romen e Qezarve, ne Romen e Papave, dhe sot e mbrapa keto vlera rraca e jone shqiptare asht shenjue te ja tregojte botes nen Romen e Benitto Mussolinit"; Ne faqen 7 vazhdon "Populli shqiptar! A e ke humbun ti pamvaresine tande? Jo, kurr! E ata Shqiptar e ata Italian qe kujtojne e thone se tashma asht bere province italiane, ma zi, nji koloni italiane, ata un u ka them kjartaz e pa perde nuk kane kuptue kurrnga nga mendimi, nga qellimi e nga vullneti i Benitto Mussolinit."

Gjith'ashtu me ane traktesh te ngjitura ndeper muret e Tiranes gjate Luftes Italo-Greke, ka shpall ne menyre demagogjike nji fjalim me titull "Luften e fitojme na!" ku ngrinte ne kulte heroizmat e ushtrise italiane dhe se aksi Rome-Berlin-Tokio do te dilte triumfues karshi aleateve Angli-Bashkim Sovietik-Amerikë.

Gjith'ashtu ka qenë nji nga shkaktaret nxitjes dhe futjes se popullit Shqiptar ne lufte kundra fqinjeve te tij Greqi – Jugosllavi dhe Aleateve duke mbajtur fjalime ne Shkoder me rastin e agresionit fashist kundra Greqisë.

Si konsulent i kultures popullore ka ekzaltue jeten dhe veprat e tradhtarit Mustafa Krujes me rastin e formimit te kabinetit Kruja dhe si president i institutit "Dante Alighieri" ka propagandue per fashizmin dhe tue perçarë popullin Shqiptar.

Mbas kapitullit t'Italise ka qene nji nga inisiatoret e organizatores e grupit fashist ne Shqiperi "Parti Indipendente" lidhur me tratharet Kol bib Mirakaj e Gjon Marka Gjoni e tjere.

Ka bashkepunuar politikisht me okupatorin nazist duke patur kontakte me agentet e tij ne Shqiperie, si kunder rezulton i provuar nga pohimi i tij ku ka thene se ka pas kontakte me Generalin Fitztum tue qene prezent Mustafa Kruja e Mark Gjon Marka per mobilizimin e popullit kondra F. N. Ç.

Ka patur lidhje te ngushta me trathtarin e njoftun Kol Ashikun, i cili edhe mbas lirimit te plote te Shqiperise nga thundra e okupatorit ka mobilizue popullin shqiptar "Malsine e Shkodres" kunder Ushtrise N. Çlirimtare, kundra interesave te nalta t'Atdheut dhe kundra Pushteti te Popullit e Ushtrise se tij te ngrehun me gjak e sakrifica. Ka manovrue deri me date 28-Janar-1945 tue qene Komandant i mbeturinave te forcave reaksionare feudale me qellim qe te luftoje kondra Ushtrise N. Çlirimtare.

NE LIGJE: Veprat si ma syperi te denuarit Don Lazer Shantoja jane nji traththi e nalte kondra Atdheut, kundra Integritetit tokesuer dhe Indipendences se Shqiperise, dhe si anmik i popullit e kriminel lufte. Njikoheisht dhe propaganda e zhvilluar prej tij, parashikohen prej neneve 15 e 16 te Ligjes

Nr. 41 D. 14-I-1945.

Mbasi i pandehuni ka vazhdue me veprat e tija trathtare kondra pushtetit dhe Ushtrise N. Ç. edhe mbas çlirimit te Shqiperise nga thundra e okupatorit Nazist, me dhe gjithë se ka marre dijenie nga shpallja e Kryesise se Keshillit Antifashist, i asht shmangur kesaj thirrje dhe perkundra ka veprue deri ne momentin e fundit ne krye te çetave te tij bashibuzuke tue rezistue me arme deri sa asht zane rob prej Ushtrise N. Çlirimtare. Keto vepra e cilesojne kete si sabotator te luftes dhe te pushtetit dhe te parashikuara prej nenit I te Ligjes Nr. 21 D. 15-12-944.

Me gjithë qe akt-gjykimi i Gjykates se faktit paraqet disa te mbeta formale, porse Gjykata e Nalte Ushtarake ka tagrin me i plotsue deri sa keto te mbeta nuk jane te nji grade sa qe te shkaktojne prishjen e akt-gjykimit, dhe se Gjykata e faktit dyke gjykuar si mbas dispozitave ligjore dhe interesave te Luftes N. Çlirimtare, me vend ka aplikue ndeshkimin e merituar ne perputhje me veprat e fajtorit.

Prandaj

Ne baze te nenit 31 te Ligjes mbi organizimin e funksionimin e Gjykatave Ushtarake Nr. 41 D. 14-1-1945, botue ne fletoren zyrtare Nr. 3 bis date 24-1-1945, konforme dhe mejtimit te Prokurorit prane kesaje Gjykate,

Vendosi

Aprovimin e akt-gjykimit te Gjykates Ushtarake te krahines Ushtarake te Korpusit III Shkoder Nr. II, D. 30-Janar-1945 si mbas te cilit asht vendosun ndeshkimi i fajtorit DON LAZER SHANTOJA nga Shkodra me VDEKJE. Njikohesisht urdherohet konfiskimi i pasunise se tij ne konformitet te dispozitave perkatese.

Tirane, me 2 Fruer 1945.

Sekretari  
(Nënshkrimi)

KRYETARI  
(Nënshkrimi)



## KOMUNIKATË

## GJYKATËS SË NALTË USHTARAKE

KËTU

Prokuroria e Gjykatës së Naltë Ushtarake, mbasi shqyrtoj akt-gjykimin e Gjykatës Usht. të Korpusit III Shkoder, nr. 11, datë 30.1.1945 me të cilin është vendos ndëshkimi i Don Lazër Shantos me vdekje në bazë të Nenit 1 të ligjës nr. 21 mbi sabotatorët e luftës e të pushtetit popullor.

## Vë re se

NË FAKTË: Don Lazër Shantoja, para datës 7 prill 1939 ka qenë në bashkëpunim dhe marrëveshje të plotë me Mustafa Krujën e me tradhtarët e tjerë për rrezimin e Zogut dhe vendosjen e një regjimi fashist në Shqipri dhe sjelljen e një princi të shtëpis së Savoia-s si Mbret i Shqipris; ka marrë subvencione nga fashizimi italian si i merguar politik. Pas okupimit të Shqipris nga Italia Fashiste, është bere vegël e verbër e okupatorit dhe e kuislingve, si p.sh. Luotenencës, Mustafa Krujës, etj, duke qenë axhitator e publicist fashist dhe duke përçarë popullin shqiptar; ka qenë një nga nxitësit e popullit shqiptar në luftë kundra fqinjve Greqi e Jugosllavi. Pas kapitullimit të Italis Fashiste ka formuar grupe fashiste në bashkëpunim me tradhetaret me damkë Kolë Bib Mirakaj, Gjon Marka Gjoni, etj.; ka pasur kontakt me krerët ushtarakë të Gjermanis Naziste në Shqipri si me Gjeneralin Fitztum, etj. dhe ka mobilizuar popull kundra Levizjes Nac.ÇL; Pas çlirimit të Shqipris, ka mobilizuar popull në Malsinë e Shkodres kundra Ushteris Nac.Çl kundra interesave të nalta të Atdheut e kundra pushtetit popullor.

NË TË DREJTE: Veprat e të dënuarit Don Lazër Shantoja janë një tradhti e naltë kundra Atdheut, kundra integritetit tokësor dhe independences së Shqipris dhe parashikohen si faj prej neneve 14 e 15 të ligjes Nr. 41, data 14 Janar 1945 e nenit 1 të Ligjës Nr. 21, data 15 Dhjetor 1944.

Për këto arësye dhe për ato që do parashtroj në rast nevojë verbalisht në Këshillë është e mejtimit që akt-gjykimi Nr. 11, datë 30 Janar 1945 të Gjykatës Ushtarake të Korpusit III-të në Shkoder të aprovohet nga Gjykata e Lartë Ushtarake.

Tiranë, më 2 Fror 1945

Prokurori  
Major Myftar Tare

## **Abstract**

Rev. Lazër Shantoja was imprisoned at the end of November 1944 and after the military court trial in Shkodra was court-marshalled by the High Military Court in Tirana and executed by gunfire in March 1945. The article focuses on some of the documents and records from his two trials and highlights the absence of the lawyer and the fact that the defendant's statements have not been recorded but only reported indirectly by the attorney. The main charges brought against him were that of being an anti-Zogan – which in fact sounds preposterous considering that the Communists, too, considered King Zog a foe, – friend to Albanian Fascist prime minister Mustafa Kruja, to Gjon Markagjoni and of having met German SS General Fitztum. His personal diary and extensive correspondence have though vanished from the trial records. Shantoja is one of the 38 Albanian martyrs that the Holy See has lately recognised due to his heroic attitude and the circumstances under which he met his end.